



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

PROJEKT- Shtesa dhe Ndryshime i Rregullores nr. 12, datë 07.04.2010 “Per te dhenat statistikore dhe financiare periodike te sipermarresve te rrjeteve dhe/ose sherbimeve te komunikimeve elektronike”)

Dokument per Keshillim Publik

_____ **2013**

(MIRATUAR ME VKD NR. ___ DATE ___ 2013)

INDEKSI I PERMBAJTJES

I. PERMBLEDHJE	3
II. RREGULLORE E AMENDUAR	8
III. PYETJE PER KESHILLIM	12

I. PERMBLEDHJE

Rregullorja nr. 12, datë 07.04.2010 “Per te dhenat statistikore dhe financiare periodike te sipermarresve te rrjeteve dhe/ose sherbimeve te komunikimeve elektronike”, eshte miratuar ne KD, me qellim percaktimin e rregullave per evidentimin e te dhenave statistikore dhe financiare periodike ne tregun e komunikimeve elektronike.

Duke marre ne konsiderate:

- zhvillimet pozitive per perdorimin e modulit on line te AKEP (www.aplikimeonline.al) si lehtesi per raportimin e te dhenave nga operatorët;
- dinamiken e sektorit dhe sherbimet e reja qe futen ne treg dhe ndryshimet ne treguesit qe AKEP duhet te raportoje ne organizmat nderkombetare

AKEP gjykon te nevojshme amendimin e rregullores Nr.12 , datë 07.04.2010 “Per te dhenat statistikore dhe financiare periodike te sipermarresve te rrjeteve dhe/ose sherbimeve te komunikimeve elektronike”.

Ndryshimet kryesore te rregullores kane te bejne me:

1. Menyren e dergimit te te dhenave statistikore dhe financiare (duke perdorur modulën on-line ne faqen zyrtare te AKEP, me qellim lehtesimin e komunikimit ndermjet AKEP dhe ofruesve te rrjeteve dhe/ose sherbimeve ne tregun e komunikimeve elektronike;
2. Heqjen e Formulareve perkates, ne versionin e “ngurtesuar” te tyre, duke i konsideruar si te mundshem per nderhyrje ne permbajtjen e tyre, ne varesi te zhvillimeve te teknologjive dhe kerkesave per te dhena shtese, duke eliminuar keshtu nevojën per amendime te mevonshme te rregullores;
3. Duke shtuar nje nen te veacnte per cilesisne dhe ruajtjen e te dhenave te raportuara ne AKEP nga sipermarresi.

Me poshte paraqiten ndryshimet e kryera ne Rregulloren Nr.12 , datë 07.04.2010 “Per te dhenat statistikore dhe financiare periodike te sipermarresve te rrjeteve dhe/ose sherbimeve te komunikimeve elektronike”, dhe bashkangjitur jane:

- **Aneks I: Rregullorja me ndryshimet e propozuara(ndryshimet jane dhene me germa italike).**
- **Aneks II: Pyetjet per konsultim publik.**

Neni 4 ishte:

Formularet

1. Informacioni dhe te dhenat qe duhet te dergojne sipermarresit e autorizuar per ofrimin e rrjeteve dhe/ose sherbimeve te komunikimeve elektronike jane percaktuar ne Aneks 1, Formularet per te dhenat e Tregut te Komunikimeve Elektronike.
2. Formularet perfshijne:
 - a. **Formulari A:** Ofrimi i rrjeteve dhe/ose sherbimeve te telefonise fikse per perdoruesit fundore dhe operatoret e tjere;
 - b. **Formulari B:** Ofrimi i rrjeteve dhe/ose sherbimeve te telefonise se levizshme per perdoruesit fundore dhe operatoret e tjere;
 - c. **Formulari C:** Ofrimi i sherbimeve te linjave me qera dhe kapaciteteve te transmetimit per perdoruesit fundore dhe operatoret e tjere;
 - d. **Formulari D:** Ofrimi i sherbimeve te Internetit per perdoruesit fundore dhe operatoret e tjere;
 - e. **Formulari E:** Te dhena financiare (te ardhura, shpenzime, fitimi dhe investime) dhe te dhena per te punesuarit;
 - f. **Formulari F:** Te dhena te detajuara sipas qytetit, fshatit te ofrimit te sherbimit te linjave te telefonise fikse dhe aksesit Broadband ne Internet per perdoruesit fundore; (specifikuar **“Harta Gjeografike Tel Fiks & Internet”**)
 - g. **Formulari G:** Tarifat e aplikuara nga sipermarresi per sherbimet e ofruara perdoruesve fundore;
3. Sipermarresi ka detyrimin te plotesoje Formularet perkates ne varesi te sherbimeve qe ofron apo perfiton nga operatoret e tjere sipas shpjegimeve te dhena ne Formularet respektive. Formulari E, te dhenat financiare dhe te te punesuarve plotesohet nga te gjithë sipermarresit.
4. Formularet jane publikuar ne faqen e Internetit te AKEP www.akep.gov.al ne seksionin **“Statistika”**

Neni 4 behet:

Formularet dhe te dhenat e kerkuara nga AKEP

1. *Informacioni dhe te dhenat qe duhet te dergojne sipermarresit e autorizuar per ofrimin e rrjeteve dhe/ose sherbimeve te komunikimeve elektronike percaktohen nga AKEP nepermjet formuleve dhe sipermarresi do te shkarkoje formularet nga moduli on-line ne cdo faze per te cilen eshte detyrim ligjor plotesimi i tyre.*
2. *Formularet perfshijne:*
 - a. **Formulari A:** *Ofrimi i rrjeteve dhe/ose sherbimeve te telefonise fikse per perdoruesit fundore (me pakice) dhe operatoret e tjere (me shumice);*
 - b. **Formulari B:** *Ofrimi i rrjeteve dhe/ose sherbimeve te telefonise se levizshme per perdoruesit fundore (me pakice) dhe operatoret e tjere (me shumice);;*

- c. **Formulari C:** Ofrimi i shërbimeve të linjave me qera dhe kapaciteteve të dedikuara për përdoruesit fundorë (me pakicë) dhe operatorët e tjerë (me shumicë);
 - d. **Formulari D:** Ofrimi i shërbimeve të Internetit për përdoruesit fundorë (me pakicë) dhe operatorët e tjerë (me shumicë);
 - e. **Formulari E:** Te dhëna financiare (te ardhura, shpenzime, fitimi dhe investime) dhe te dhëna për të punësuarit. (Ky formular plotësohet nga të gjithë sipërmarrësit).
3. Formularet me treguesit përkatës dhe shpjegimet e nevojshme publikohen nga AKEP në modulën përkatës on-line (www.aplikimeonline.al). Përbajtja e formulareve mund të ndryshojë për t'iu përgjigjur zhvillimeve dinamike të tregut dhe detyrimeve të AKEP për të plotësuar kërkesat e institucioneve ndërkombëtare.
4. AKEP mund të kërkojë të dhëna shtesë, jo të specifikuar në formulare, nëpërmjet njoftimeve në formë shkresore, në të cilat përcaktohet lloji, afatet për dërgimin e të dhënave si dhe qëllimi i kërkesës.

Neni 5 ishte:

Menyra e dërgimit si dhe afatet e plotësimit të formulareve

1. Informacioni dhe të dhënat e kërkuara sipas Formulareve **A**, **B**, **C**, **D**, **F** dhe **G**, të dërgohen nga sipërmarrësi çdo 6 muaj:
 - a. Brenda datës **31 Korrik** të çdo viti: të dhënat e gjashtëmuajorit të parë të vitit kalendarik korrent: (përfshihen të dhënat e periudhës Janar-Qershor)
 - b. Brenda datës **31 Janar** të çdo viti: të dhënat vjetore të vitit kalendarik paraardhës (përfshihen të dhënat e periudhës Janar-Dhjetor)
2. Informacioni dhe të dhënat e kërkuara sipas Formularit **E** (Te dhëna Financiare), të dërgohen nga sipërmarrësi një herë në vit, brenda datës **10 Prill** të vitit kalendarik pasardhës. (që përfshijne periudhën Janar-Dhjetor)
3. Formularet e plotësuar nga sipërmarrësi dërgohen në AKEP si në vijim:
 - a. Një shkresë shoqëruese të firmosur nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit;

- b. Formularet e plotësuar te printuar (te njejte me informacionin ne forme elektronike), te mbyllur dhe vulosur ne zarf te vecante me shenimin **“Formularet Statistikore Periodik per AKEP**
- c. Format elektronik ne Microsoft Excel ne CD (te firmosur).

Neni 5 behet:

Afatet e plotësimit te formulareve dhe menyra e raportimit

1. Informacioni dhe te dhenat e kerkuara sipas Formulareve **A, B, C D**, raportohen on-line nga sipërmarrësi cdo 6 muaj:
 - a. Brenda dates **31 Korrik** te cdo viti: te dhenat e gjashtemujorit te pare te vitit kalendarik korrent: (perfshihen te dhenat e periudhes Janar-Qershor)
 - b. Brenda dates **31 Janar** te cdo viti: te dhenat vjetore te vitit kalendarik paraardhes (perfshihen te dhenat e periudhes Janar-Dhjetor)
2. Informacioni dhe te dhenat e kerkuara sipas Formularit **E** (Te dhena Financiare), raportohen nga sipërmarrësi nje here ne vit, brenda dates **10 Prill** te vitit kalendarik pasardhes. (qe perfshijne periudhen Janar-Dhjetor).
3. *Sipërmarrësi ka detyrimin qe per cdo periudhe raportimi:*
 - a. *te shkarkoje lokalisht nga moduli on-line i AKEP Formularet perkates ne varesi te sherbimeve qe ofron apo perfiton nga operatorët e tjere sipas shpjegimeve te dhena ne Formularet respektive.*
 - b. *te plotësoje formularet perkates sipas udhezimeve ne kete rregullore per afatet e raportimit dhe sipas pershkrimeve te dhena ne formularet e treguesve..*
 - c. *te ngarkoje formularet e plotësuar ne modulin on-line te AKEP.*
4. *Per perdorimin e modulit on line te AKEP, sipërmarrësi mund te perdore ndihmesen qe ofrohet ne MENUNE E MODULIT ON-LINE: “MANUALE TE NEVOJSHME ” ne zerin “Raportime Formularesh”.*

Eshte shtuar nje Nen i ri me numrin 6 (nenet e mepashme kane nderruar numertim)

Neni 6

Cilësia e të dhënave

Sipërmarrësi duhet të garantojë plotësimin e të gjithë treguesve të kërkuar dhe të dhënat e raportuara duhet të jenë të krahasueshme me periudha të mëparshme raportimi. Sipërmarrësit

Adresa: Rr. “Abdi Toptani”,
Godina Torre Drini, K. IX, Tiranë

Tel : ++ 355 4 2259 571
Fax : ++ 355 4 2259 106

www.akep.al
info@akep.al

duhet të sigurojnë integritetin e të dhënave përgjatë periudhave kohore të raportuara duke mbajtur një gjurmë të përshtatshme auditimi të mundshëm nga AKEP për të gjithë informacionin e raportuar.

1. Krahasueshmëria

Sipërmarrësit duhet të raportojnë të dhënat duke iu referuar përshkrimeve të dhëna nga AKEP dhe njëkohësisht treguesit e raportuar duhet të jenë të krahasueshëm në periudha të ndryshme. Në rast të ndryshimit të mënyrës së matjes së një treguesi nga sipërmarrësi, ai duhet të vendosë sqarimin përkatës, arsyen dhe vlerat e treguesit për periudhat e mëparshme të raportuara sipas mënyrë së re të matjes.

2. Ruajtja e të dhënave

Të gjitha informacionet e raportuara në AKEP duhet të ruhen nga sipërmarrësi, duke krijuar mundësinë për të provuar vërtetësinë e treguesve të raportuar dhe mënyrës së matjes së tyre, në rast verifikimi të tyre nga AKEP. Afati për ruajtjen të dhënave të raportuara dhe provat e matjes së tyre është 3 vjet.

Neni 6 ishte:

Verifikimi nga AKEP i te dhenave

- 1.** Nese te dhenat e derguara nga sipermarresi nuk jane ne standartin e te dhenave te kerkuara nga AKEP dhe krijojne dyshime mbi saktesine e tyre:
 1. AKEP mund te kerkoje sqarime sipermarresit apo Personit te kontaktit me shkrese apo me telefon dhe/ose me e-mail.
 2. Sipermarresi/Personi i kontaktit duhet te jape sqarime dhe informacionin e sakte qe ploteson kriteret e percaktuara ne formularet e te dhenave, brenda 10 diteve nga marrja e kerkeses se AKEP per sqarime te cituar ne piken 'a'.
 3. AKEP mund te kryeje verifikime te saktetise se te dhenave te depozituara nga sipermarresi, nepermjet inspektimit ne ambientet/dokumentacionin e sipermarresit.

Behet Neni 7:

Verifikimi nga AKEP i te dhenave

Nese te dhenat e derguara nga sipermarresi nuk jane ne standartin e te dhenave te kerkuara nga AKEP dhe krijojne dyshime mbi saktesine e tyre:

1. *AKEP mund te kerkoje sqarime sipermarresit apo Personit te kontaktit nepermjet te gjithave menyra te komunikimit si: duke perdorur moduln on-line, me shkrese, me telefon dhe/ose me e-mail.*
2. Sipermarresi/Personi i kontaktit duhet te jape sqarime dhe informacionin e sakte qe ploteson kriteret e percaktuara ne formularet e te dhenave, brenda 10 diteve nga marrja e kerkeses se AKEP per sqarime te cituar ne piken 'a'.
3. AKEP mund te kryeje verifikime te saktesine se te dhenave te depozituara nga sipermarresi, nepermjet inspektimit ne ambientet/dokumentacionin e sipermarresit.

Aneks I: Propozimi per ndryshimet ne:

RREGULLORE

PER

**TE DHENAT STATISTIKORE DHE FINANCIARE PERIODIKE TE
SIPERMARRESVE TE RRJETEVE DHE/OSE SHERBIMEVE TE KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE**

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është percaktimi i te dhenave periodike per sherbimet dhe rrjetet e komunikimeve elektronike te ofruara nga sipermarresit e pajisur me autorizim te pergjithshem nga AKEP, detyrimet dhe rregullat per sipermarresit per depozitimin informacionit.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore dhe te dhenat e kerkuara nepermjet kesaj rregulloreje jane hartuar ne zbatim te kompetencave te AKEP te percaktuara ne Nenin 8 (germa o, germa p), dhe detyrimit te sipermarresve per te derguar informacion ne AKEP sipas Nenit 16 të Ligjit Nr.9918, date 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, *i ndryshuar*.

Neni 3

Detyrimet e sipermarresve per dergimin e te dhenave

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga te gjithë sipermarresit qe ofrojne rrjete dhe/ose sherbime te komunikimeve elektronike te cilet bejne pjese ne regjistrin e sipermarresve te publikuar ne faqen zyrtare te AKEP
2. Cdo sipermarres ka detyrimin qe te plotesoje Formularet e listuar ne nenin 4 (ne vijim), duke derguar formularet dhe informacionin e kerkuar sipas procedurave dhe afateve te kesaj rregulloreje.
3. Cdo sipermarres zbaton detyrimin e cituar ne piken 2 te ketij neni, si dhe detyrimet e tjera ne kete rregullore.

Neni 4

Formularet dhe te dhenat e kerkuara nga AKEP

5. Informacioni dhe te dhenat qe duhet te dergojne sipermarresit e autorizuar per ofrimin e rrjeteve dhe/ose sherbimeve te komunikimeve elektronike percaktohen nga AKEP nepermjet formulareve dhe sipermarresi do te shkarkoje formularet nga moduli on-line ne cdo faze per te cilen eshte detyrim ligjor plotesimi i tyre.
6. Formularet perfshijne:
 - a. **Formulari A:** Ofrimi i rrjeteve dhe/ose sherbimeve te telefonise fikse per perdoruesit fundore (me pakice) dhe operatoret e tjere (me shumice);
 - b. **Formulari B:** Ofrimi i rrjeteve dhe/ose sherbimeve te telefonise se levizshme per perdoruesit fundore (me pakice) dhe operatoret e tjere (me shumice);;
 - c. **Formulari C:** Ofrimi i sherbimeve te linjave me qera dhe kapaciteteve te dedikuara per perdoruesit fundore (me pakice) dhe operatoret e tjere (me shumice);
 - d. **Formulari D:** Ofrimi i sherbimeve te Internetit per perdoruesit fundore (me pakice) dhe operatoret e tjere (me shumice);
 - e. **Formulari E:** Te dhena financiare (te ardhura, shpenzime, fitimi dhe investime) dhe te dhena per te punesuari. (Ky formular plotesohet nga te gjithë sipermarresit).
7. Formularet me treguesit perkates dhe shpjegimet e nevojshme publikohen nga AKEP ne modulin perkates on-line (www.aplikimeonline.al). Permbajtja e formulareve mund te ndryshoje per t'iu pergjigjur zhvillimeve dinamike te tregut dhe detyrimeve te AKEP per te plotesuar kerkesat e institucioneve nderkombetare.
8. AKEP mund te kerkoje te dhena shtese, jo te specifikuara ne formulare, nepemjet njoftimeve ne forme shkresore, ne te cilat percaktohet lloji, afatet per dergimin e te dhenave si dhe qellimi i kerkeses.

Neni 5

Afatet e plotesimit te formulareve dhe menyra e raportimit

1. Informacioni dhe te dhenat e kerkuara sipas Formulareve **A**, **B**, **C** **D**, raportohen on-line nga sipermarresi cdo 6 muaj:
 - a. Brenda dates **31 Korrik** te cdo viti: te dhenat e gjashtemujorit te pare te vitit kalendarik korrent: (perfshihen te dhenat e periudhes Janar-Qershor)
 - b. Brenda dates **31 Janar** te cdo viti: te dhenat vjetore te vitit kalendarik paraardhes (perfshihen te dhenat e periudhes Janar–Dhjetor)

2. Informacioni dhe te dhenat e kerkuara sipas Formularit **E** (Te dhena Financiare), raportohen nga sipermarresi nje here ne vit, brenda dates **10 Prill** te vitit kalendarik pasardhes. (qe perfshijne periudhen Janar-Dhjetor).
3. *Sipermarresi ka detyrimin qe per cdo periudhe raportimi:*
 - a. *te shkarkoje lokalisht nga moduli on-line i AKEP Formularet perkates ne varesi te sherbimeve qe ofron apo perfiton nga operatoret e tjere sipas shpjegimeve te dhena ne Formularet respektive.*
 - b. *te plotesoje formularet perkates sipas udhezimeve ne kete rregullore per afatet e raportimit dhe sipas pershkrimeve te dhena ne formularet e treguesve..*
 - c. *te ngarkoje formularet e plotesuar ne modulin on-line te AKEP.*
4. *Per perdorimin e modulit on line te AKEP, sipermarresi mund te perdore ndihmesen qe ofrohet ne MENUNE E MODULIT ON-LINE: “MANUALE TE NEVOJSHME ” ne zerin “Raportime Formularesh”.*

Neni 6

Cilësia e të dhënave

Sipërmarrësi duhet të garantojë plotësimin e të gjithë treguesve të kërkuar dhe të dhënat e raportuara duhet të jenë të krahasueshme me periudha të mëparshme raportimi. Sipërmarrësit duhet të sigurojnë integritetin e të dhënave përgjatë periudhave kohore të raportuara duke mbajtur një gjurmë të përshtatshme auditimi të mundshëm nga AKEP për të gjithë informacionin e raportuar.

1. Krahasueshmëria

Sipërmarrësit duhet të raportojnë të dhënat duke iu referuar përshkrimeve të dhëna nga AKEP dhe njëkohësisht treguesit e raportuar duhet të jenë të krahasueshëm në periudha të ndryshme. Në rast të ndryshimit të mënyrës së matjes së një treguesi nga sipërmarrësi, ai duhet të vendosë sqarimin përkatës, arsyen dhe vlerat e treguesit për periudhat e mëparshme të raportuara sipas mënyrë së re të matjes.

2. Ruajtja e të dhënave

Të gjitha informacionet e raportuara në AKEP duhet të ruhen nga sipërmarrësi, duke krijuar mundësinë për të provuar vërtetësinë e treguesve të raportuar dhe mënyrës së matjes së tyre, në rast verifikimi të tyre nga AKEP. Afati për ruajtjen të dhënave të raportuara dhe provat e matjes së tyre është 3 vjet.

Neni 7

Verifikimi nga AKEP i te dhenave

Nese te dhenat e derguara nga sipermarresi nuk jane ne standartin e te dhenave te kerkuara nga AKEP dhe krijojne dyshime mbi saktesine e tyre:

1. *AKEP mund te kerkoje sqarime sipermarresit apo Personit te kontaktit nepermjet te gjithave menyrave te komunikimit si: duke perdorur moduln on-line, me shkrese, me telefon dhe/ose me e-mail.*
2. Sipermarresi/Personi i kontaktit duhet te jape sqarime dhe informacionin e sakte qe ploteson kriteret e percaktuara ne formularet e te dhenave, brenda 10 diteve nga marrja e kerkeses se AKEP per sqarime te cituar ne piken 'a'.
3. AKEP mund te kryeje verifikime te saktesine se te dhenave te depozituara nga sipermarresi, nepermjet inspektimit ne ambientet/dokumentacionin e sipermarresit.

Neni 8

Perdorimi i te dhenave nga AKEP

1. AKEP, nepermjet Njesise pergjegjese per Statistikat (Sektori i Analizes se Tregut), do te beje perpunimin e informacionit periodik te depozituar nga sipermarresi, infomacion i cili do te sherbeje si element baze per:
 - a) Monitorimin e vazhdueshem te zhvillimit te tregut te komunikimeve elektronike ne Shqiperi per plotesimin e objektivave rregullatore te AKEP si dhe politikes sektoriale;
 - b) Zhvillimin e analizave te tregjeve nga AKEP;
 - c) Informacion per publikun nepermjet raporteve periodike qe evidentojne treguesit kryesore te zhvillimit te tregut;
 - d) Plotesimin e kerkesave te institucioneve kombetare dhe nderkombetare qe monitorojne zhvillimin e tregut te komunikimeve elektronike ne Shqiperi;
2. AKEP zbaton parimet e konfidencialitetit ne publikimin dhe perdorimin e te dhenave te tregut te komunikimeve elektronike.

Neni 9

Sanksionet

Mos-dergimi i Formulareve te plotesuar sipas afateve dhe kerkesave te AKEP te percaktuara ne kete rregullore, perben shkelje te nenit 16 te ligjit nr.9918, i ndryshuar dhe kundervajtje administrative e sanksionuar sipas nenit 137.

Neni 10

Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hyn ne fuqi menjehere, pas miratimit ne KD

Aneks II. Pyetje per Keshillim Publik

1. A jeni dakort me faktoret e konsideruar nga AKEP per amendimin e Rregullores Nr.12 date 07.04.2010 “Per te dhenat statistikore dhe financiare periodike te sipërmarresve te rrjeteve dhe/ose sherbimeve te komunikimeve elektronike”?
2. Si mendoni ne percaktimin e bere ne rregullore sipas se ciles AKEP kerkon te dergohen te dhenat e kerkuara ne versionin on-line nepermjet faqes zyrtare te AKEP, (www.aplikimeonline.al)?
3. Si mendoni per propozimin e AKEP qe Formularet e treguesve te mos jene te ngurtesuar ne kete rregullore, por te jene fleksibel per ndryshime te mevonshme nepermjet perdorimit te modulit on-line?